Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**10.01.2024**	**18.01.2024**	**2023/1047**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.12.2023, OE "Letamed SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1047, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Pro Medical SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje stomatologjike - Ritenderim" me nr. të prokurimit: "611-23-12208-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA GLLOGOC.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 81,100 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 03/11/2023

Hapja e ofertave: 13/11/2023

Vendimi i AK-së: 15/12/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1047 i dt:23.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 11 Informatat Sekrete Afariste

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

AK me date: 15.12.2023 na ka derguar njoftim vendimin B58 dhe Letren standarde si ten derues i pa sukseshem.

Pasi kemi analizuar vendimin e AK te dates 15.12.2023, dhe duke marr parasysh faktin se AK ka propozuar per kontrate nje OE te pa pergjegjshem, kemi kerkuar qasje ne dokumente zyrtare dhe AK na ka ftuar per qasje me date 18.12.2023.

Por qasja nuk na eshte ofruar konform LPP-se, sepse OE I rekomanduar , ne ANEKS 3 te Dosjes së Tenderit ka specifikuar kerkesa te cilat nuk duhet te jene sekret afarist që është në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së, ndersa AK konform kerkeses jo ligjore te OE te rekomanduar nuk na ka ofruar deshmite e kerkuara. Po ashtu ne kemi kërkuar

dështmitë e OE për këtë aktivitet të prokurimit, qka nënkupton se është dashur të na jep edhe ofertën e OE NARABIOTIKS shpk, por një gjë të tillë nuk e ka bërë AK dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së.

Me datë: 19.12.2023 kemi bërë kërkesë për RISHQYRTIM dhe AK Komuna Drenas, me datë: 20.12.2023 na ka REFUZUAR kërkesën pa u përgjigjur fare në pterendimet tona ankimore siq kërkohet me nenin Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Pra AK pa hyrë fare në detale të pretendimeve tona ankimore ka REFUZUAR kërkesën dhe ka bërë shkeljen e radhës.

Me OE te rekomanduar ne kemi nje pervoje te ngjajshme ne disa Autoritete Kontraktuese, sepse i njejti ngase nuk i ploteson kerkesat e FDT-se per tu mbrojtur nga ajo qe nuk ka deshmite e kerkuara me FDT, e ben kerkesen per sekret afarist dhe Autoritetet Kontraktuese, duke u mbeshtetur ne kete dokument, nganjëher e rekomandojne per fitues edhe pse i njejti **nuk i ploteson kerkesat e FDT-se respektivisht kërkesat e nenin 69 të LPP-së.**

OE i rekomanduar, perkunder qe AK nuk na ka oftruar qasje, por ne e njohim si konkurent dhe ne disa AK (si shembull ne AK Komuna Rahovec) kemi patur qasje ne oferten e ketij OE dhe ky OE te cilin ju e keni propozuar per kontrate, ka ofruar edhe per AK Komuna Drenas, Autorizimin nga prodhuesi nga nje PRODHUES tjeter, ndersa Certifikatat ISO dhe CE si dhe IEC i ka te nje Prodhuesi tjeter dhe nuk kanë lidhmëri me OE të rekomanduar (së fundmi edhe Komuna e Prizrenit e ka eleminuar për të njëjtën qështje).

Po ashtu ky OE për këtë aktivitet të prokurimit në Dosjen e Tenderit ka bërë ankesë në OSHP sa i përket certifikatës IEC, qka nënkupton se OE i rekomanduar nga Komuna Drenas, nuk ka certifikatë IEC të kërkuar me Dosje të Tenderit në pikën: **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 3 Certifikata IEC.**

Pra nese OSHP I verifikon deshmite e këtij OE do ta veren se AUTORIZIMI, KATALOGU dhe Certifikatat ISO se bashku me CE dhe IEC nuk perputhen sepse jane te prodhuesve te ndryshem dhe nuk kanë të bëjnë me këtë Operator Ekonomik. Vlerësimi I bërë nga Komuna Drenas dhe Vendimi I datës 15.12.2023 janë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Pra AK Komuna e Drenasit ka vepruar ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se dhe ka vepruar ne kundershtim me nenin Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, sepse ka rekomanduar per kontrate nje OE te pa pergjegjshem dhe me vendimin e dates 15.12.2023

ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren për prokurim publik 001/2022.

Po ashtu AK Komuna e Dransit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ku OE NARABIOTIKS SHPK, e ka vlerësuaer si OE i përgjegjshëm, sepse i njëjti është biznes i ri dhe nuk ka kontrata dhe referenca të natyrës së kërkuar me FDT. Respektivisht ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së konform nenit 69 të LPP-së.

Kerkojme nga OSHP që të aprovojë ankesën tonë, të detyrojë AK që lëndën ta kthejë në RIVLERËSIM, dhe në respektim të nenit 59 dhe 69 të LPP-së të na shpall neve fitues si OE i pergjegjshem me çmimin me te ulet ne kete procedure siq kërkohet me nenin 1 të LPP-së:

Neni 1 Qëllimi:

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional **1. Të paraqitën Kontratat e furnizimeve të natyrës se ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë min 80,000€**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjajshme , kopjet e kontratave te bashkangjitura me (raportet e pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencavenjeren prej tyre) ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj. institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat**
2.Aparatet te jane prodhim i njerit nga vendet e bashkimit Europian, ose prodhimet te standardeve Evropiane.	**1.Deshmi nga prodhuesi qe Aparatet do te jete prodhim i njerit nga vendet e bashkimit evropian ose te jane prodhime te standardeve evropiane**
3.Aparati (Karriga stomatologjike) të ketë CE qertifikatë – dhe cilësa e pajisjeve (Karriga stomatologjike) të dëshmohet me certifikatë e cila tregon se prodhuesi konfirmon se produkti plotëson kërkesat e BE-së për sigurinë, shëndetin ose mjedisin konformë rregullave- standardeve IEC.	**3. CE Cerifikatat për aparatet e kërkuara në Paramasa (IEC) – Kopje**
4.Prodhuesi te kete ISO qertifikate	**4.ISO certifikata nga prodhuesi-Kopje**
5.Autorizim nga prodhuesi per shitjen e ketyre produkteve shitjen e ketyre produkteve	**5.Te ofrohet autorizim nga prodhuesi per shitjen e ketyre produkteve - Kopje**
6.Katalogjet me nenvizim te specifikave	**6.Te ofrohen katalogjet**
7.Garancioni per paisjen nje vite	**7.deklarata e garacionit**
8.Te kete servisim te rregullt nga srviser te trajnuar per aparaturen e ofruar	**8. Te kete servisim te rregullt , nga serviser te trajnuar per aparaturen e ofruar, te deshmohet me certifikate trajnimi.-Kopje**
9.Garancion per furnizim me pjese rezerve ne afat deri ne 5 vite	**9.Garancion per furnizim me pjese rezerv ne afat deri ne 5 vite - Kopje**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
ZYRA E PROKURIMIT

Shkresë	**20.12.2023**
Nga:	ZPP GEZIM HAJDINI
PER:	Letamed SH.P.K
Lënda :	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin ~~Publik~~ nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësur me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik në Kosovë,përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kerkesave për Rishqyrtim në Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë:

VENDIM

1. **Refuzohet e pabazuar kërkesa per rishqyrtim e operatorit ekonomik: "Letamed SH.P.K kundër NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES (B58-) për projektin** "Furnizim me pajisje stomatologjike – Ritenderim me numer prokurimit 611-23-12208-1-2-1

Arsyetim

1. Refuzohet e pabazuar sepse ne si Autoritet kontraktues ju kena lejuar qasjen me datë 18.12.2023, ku ju jeni njoftuar ne zyren e prokurimit se Operatori Ekonomik i shpallur fitues sipas rekomandimeve te komisionit vleresimit ka dokumenta sekrete afariste pervec disa dokumentave tjera si ARBK , Deklarata nën betim, Lista e kontratave te realizuara, Katalogjet me nenvizim te specifikave, Deklarata mbeshtetes, Sigurimi tenderit. Por ju si Operator Ekonomik nuk keni pranuar vetem keni kerkuar te pranoni dokumentin e paraqitur si sekrete afariste nga operatori ekonomik si perfitues. Si dhe mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Pala e kenaqur mund te beje ankesa ne oshp brenda 10 ditë
Me respekt!

Aneksi 3 KËRKESA PËR SEKRET AFARIST

Për: KOMUNA GLLOGOC

(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE *PRO MEDICAL* (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, Paragrafi 8 dhe 9 të Informacionit për Tenderuesit, ka dërguar informacionet sekrete afariste, si në vijim:

Te gjitha dokumentacion sipas Neni 11 te LPP klasifikohen si sekret afarist si:

- Kerkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas kërkesave ne nenin 68 dhe 69 si : Deklarata për specifikacionin teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu, CE,ISO,Certifikata dhe autorizimet.

Te gjitha janë keto dokument te cekura me lart te klasifikon si SEKRET AFARIST

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Kerkojm nga AK qe te vperoj konfrom Nenit 11 te LPP duke e respketuar informatat

sekrete afariste te OE, ne kete rast te Pro Medical.

Pro Medical deklarojm se infromatat e cekura me lar t(Autorzime,certificate,katalogjet)

i konsiderojm si prone jo publike dhe cdo qasje ne infromatat e till do te rezultone ne demtimin material te interesave legjithme komericale dhe finaciare te Pro Medical .

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	PRO MEDICAL
Adresa e plotë:	KADRI ZEKA,FERIZAJ
I përfaqësuar nga:	
Emri:	ADNAN BALA
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	13.11.2023
Vula:	PRO MEDICAL FERIZAJ

PRO MEDICAL

Lënda : Kërkesë
Për : Zyren e Prokurimit
Nga : PRO MEDICAL
Data : 13.11.2023
Titulli : Kërkese per konfidencialitet

KËRKESË PËR KONFIDENCIALITET

Me ketë kerkesë po ju drejtohet AK qe ne OE" PRO MEDICAL" në rrugën Kadri Zeka,Ferizaj si pjesëmarrës në këtë tender ne kërkoj që dokumente si më posht:

- ***Kërkesa mbi gjendje ekonomike dhe finaciare sipas kerkesave në nenit 7.1 & 7.2 pra Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj CE Certifikatën përkatëse për produktet e ofruara.***

- ***Kerkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sipas kërkesave ne nenin 9.1 & 9.2 të FDT pra si: Kërkohet që OE të prezantoj katalogun ose broshurën e pajisjeve të ofruara dhe të nënvizohen në mënyre të qartë produktet dhe specifikat teknike të ofruara, ISO,CE,Autorizimet,Certfikatat dhe dokumentet tjera sipas nrnit 68 dhe 69.***

Te gjitha keto dokumente jane klasifikuar si sekret afarist konfrom LPP Neni 11 ne kërkojm nga AK që mos bëjë publike apo jep qasje OE në dokumente e cekura me lart edhe te klasifikon si sekret afarist.

Kerkojm nga AK qe te veproj konfrom Nenit 11 te LPP duke e respketuar informatat sekrete afariste te OE Pro Medical.
Ne kerkojm qe AK ne pajtim RRPP qe AK te merr Vendim dhe te aprovoj kërkesën tone që dokumentet si ne vijim:

a. informacionet ne lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe
b. informacionet ne lidhje me mundesite teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se

Te jene sekret afarsi pra konfidenciale konfrom LPP.

Ne pajtim me nenin 7.3 te RrPP pas perfundimit te aktivitetit te prokurimit vetem informatat e klasifikuara, nga OE dhe te pranuara nga AK, si sekrete te biznesit do te mbesin sekrete per te gjitha palet duke perjashtuar KRPP, OSHP, perfshire ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.

ARSYTIMI

Ne Pro Medical deklarojm se dokumente e cekura me lart i konsiderojm si prone jo publike dhe cdo qasje ne informacione e till do te rezultone ne demtimin material te interesave legjithme komericale dhe finaciare te kompanis tonë Pro Medical dhe partnerve tane afaristë.

Çdo shperndarje dhe qasje ne dokumente e cekur me larte do bie ndesh me ligjet ne fuqi dhe kerkesa është në përputhje me LPP Neni 11 dhe RrPP Neni 7.5 te konsiderohen si sekret afarist.

Duke marr parasysh nga e eksperienca qe kemi OE tjere konkuruse po dëmëtojn raport tone me partneret dhe bashkëpunetore tone afarist jashtë Kosoves duke i kontaktuar ata si psh duke kërkuar të jenë distributor të tyre, duke shantazhur dhe në disa rast duke dëmtuar marrdhenje tone afariste me ta dhe ne disa rast kompania jone ka pasur humbje finaciare nga OE e papërgjeshëm, ne kërkojm nga AK që dokumente e cekura më lart të kalasifikohen si sekret afarist sipas LPP.

Për dhe në emër të:
PRO MEDICAL –Adnan Bala

Drejtor

PRO MEDICAL

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Letamed SH.P.K.**

Sqarim hyrës: Pas publikimit të vendimit të AK-së, OE ankues si palë e pakënaqur ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së duke ngritur disa pretendime në lidhje me operatorët pjesëmarrës, për të cilat eksperti ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"Me datë: 19.12.2023 kemi bërë kërkesë për RISHQYRTIM dhe AK Komuna Drenas, me datë: 20.12.2023 na ka REFUZUAR kërkesën pa u përgjigjur fare në pterendimet tona ankimore siq kërkohet me nenin Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Pra AK pa hyrë fare në detale të pretendimeve tona ankimore ka REFUZUAR kërkesën dhe ka bërë shkeljen e radhës."*

Pretendimi që AK nuk është përgjigjur në pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim nga ana e OE ankues, sipas ekspertit qëndron. Neni 108/A, pika 9 e LPP-së, kërkon që në rast të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, AK duhet të arsyetoj dhe arsyetimi t'i komunikohet me shkrim parashtruesit të ankesës dhe palëve të interesuara. Duke u bazuar në përgjigjen e dhënë nga AK, si përgjigje ndaj pretendimeve të ngritura në kërkesën për rishqyrtim, AK nuk është përgjigjur fare në ato pretendime. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar.

Pretendimi 2

"*OE i rekomanduar, perkunder qe AK nuk na ka oftruar qasje, por ne e njohim si konkurent dhe ne disa AK (si shembull ne AK Komuna Rahovec) kemi patur qasje ne oferten e ketij OE dhe ky OE te cilin ju e keni propozuar per kontrate, ka ofruar edhe per AK Komuna Drenas, Autorizimin nga prodhuesi nga nje PRODHUES tjeter, ndersa Certifikatat ISO dhe CE si dhe IEC i ka te nje Prodhuesi tjeter dhe nuk kanë lidhmëri me OE të rekomanduar (së fundmi edhe*

Komuna e Prizrenit e ka eleminuar për të njëjtën qështje). Po ashtu ky OE për këtë aktivitet të prokurimit në Dosjen e Tenderit ka bërë ankesë në OSHP sa i përket certifikatës IEC, qka nënkupton se OE i rekomanduar nga Komuna Drenas, nuk ka certifikatë IEC të kërkuar me Dosje të Tenderit në pikën: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 3 Certifikata IEC. Pra nese OSHP I verifikon deshmite e këtij OE do ta veren se AUTORIZIMI, KATALOGU dhe Certifikatat ISO se bashku me CE dhe IEC nuk perputhen sepse jane te prodhuesve te ndryshem dhe nuk kanë të bëjnë me këtë Operator Ekonomik. Vlerësimi I bërë nga Komuna Drenas dhe Vendimi I datës 15.12.2023 janë në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së."

Sa i përket pretendimit të dytë të ngritur nga OE ankues, eksperti sqaron se në Dosje të Tenderit, është kërkuar që operatorët pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit duhet të dorëzojnë me ofertë edhe CE certifikatat për aparatet e kërkuara në paramasë (IEC), e cila tregon se prodhuesi konfirmon se produkti plotëson kërkesat e BE-së për sigurinë, shëndetin ose mjedisin konformë rregullave standarde IEC. Po ashtu është kërkuar të dorëzohet edhe autorizim nga prodhuesi për shitjen e këtyre produkteve. OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar tre autorizime të prodhuesve të ndryshëm, në anën tjetër ky operator ka dorëzuar edhe disa certifikata ISO dhe CE sa i përket produkteve të kërkuara në paramasë, mirëpo eksperti pasqyron që këto certifikata të dorëzuara, shumica prej tyre paraqiten të jenë certifikata të prodhuesve të tjerë, ndryshe nga autorizimet e dorëzuara në ofertë dhe të marra nga prodhuesit. Në certifikatat e dorëzuara, vetëm njëra prej tyre, mund të merret si konform kërkesave të DT-së dhe ato janë certifikatat CE dhe ISO e prodhuesit në autorizimin e fundit të përfshirë në ofertë (faqe 14-16 të pikës 2 të ofertës) dhe keto certifikata mbulojnë vetëm një pjesë të pajisjeve të kërkuara përmes paramasës, pjesa tjetër e certifikatave të prezantuara janë të prodhuesve të ndryshëm të cilat nuk përkojnë me autorizimet e dorëzuara në të cilat dallojnë prodhuesit.

Sipas mendimit të ekspertit këto certifikata të prodhuesve të ndryshëm, për të cilët nuk është ofruar asnjë autorizim nuk i përmbushin kërkesat e DT-së. Po ashtu edhe katalogjet e dorëzuara në ofertë nuk janë katalogjet e prodhuesit prej të cilit është paraqitur autorizimi për shitje të pajisjeve, por këto pajisje në katalog janë pajisje të prodhuesve krejtësisht të tjerë. Duke u bazuar në këtë çfarë sqaruam më lartë, eksperti konsideron që nga OE i rekomanduar nuk janë përmbushur kërkesat sipas dosjes së tenderit. Andaj, ky pretendim është i bazuar.

Pretendimi 3

"Po ashtu AK Komuna e Dransit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së ku OE NARABIOTIKS SHPK, e ka vlerësuaer si OE i përgjegjshëm, sepse i njëjti është biznes i ri dhe nuk ka kontrata dhe referenca të natyrës së kërkuar me FDT. Respektivisht ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT-së konform nenit 69 të LPP-së."

Sa i përket këtij pretendimi, eksperti shqyrtues pas analizimit të dokumenteve të dorëzuara nga OE i dytë më i lirë sipas çmimit, sqaron se ky operator përmbushë kriteret e DT-së, ku janë kërkuar që OE ofertues të paraqesin kontrata për furnizim të natyrës së ngjashme në tre vitet e

shkuara minimum vlera prej 80,000 euro. Ky operator e ka përmbushur këtë kriter, ku ka ofruar dëshmitë përkatëse sipas kërkesave të DT-së dhe e ka tejkaluar edhe shumën e kërkuara (pika 3 e ofertës së OE i renditur i dyti sipas çmimit të ofertuar). Andaj, ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA GLLOGOC**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Letamed SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Agnese Ibrahimi

Ibrahimi